



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 05.05.2015, ora 18:00

Drejton mbledhjen:

Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.
2. Seancë dëgjimore me zonjën Klajda Gjoshja.
3. Kalendar i punimeve të Komisionit për Integrimin Europian për periudhën 1-22 maj 2015.

Marrin pjesë:

Majlinda Bregu, Esmeralda Shkja, Ilir Xhakolli, Taulant Balla, Bujar Derveni, Edi Paloka, Sadri Abazi dhe Gerti Bogdani.

Mungojnë:

Arben Imami, Gramoz Ruçi dhe Kejdi Mehmetaj.

Të ftuar:

Klajda Gjoshja – ministre e Integritit Europian.

Ilirjan Xhezo – drejtor i Politikave Sektoriale në Ministrinë e Integritit Europian.

Altin Fuga – drejtor i Sekretariatit për Çështjet Europiane në Ministrinë e Integritit Europian.

HAPET MBLEDHJA

Majlinda Bregu – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar të komisionit, programin e punës së komisionit për periudhën 1-22 maj...

Me thënë të drejtën, me gjithë fushatën, janë disa ligje të cilat duhet të kalojnë. Kështu që në mirëkuptim, duke e ditur që keni nevojë të merreni edhe me punë të tjera, të caktojme datat kryesore kur do të diskutojmë dhe miratojmë projektligjet.

Gjithashtu, kemi seancën dëgjimore me ministren e Integritimit European, zonjën Klajda Gjoshja, e cila pritët të vijë pas pak, pasi kishte një angazhim, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Atëherë, fillojmë me projektligjin për të vazhduar më pas me ministren.

Zoti Balla, amendamentet e projektligjit janë tuajat, apo jo?

Taulant Balla – Po.

Majlinda Bregu – Atëherë, na bëni një prezantim dhe pastaj do të dëgjojmë mendimin e Njësisë së Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend.

Taulant Balla – Të nderuar kolegë,

Nisur nga e drejta kushtetuese e një deputeti, unë kam ndërmarrë iniciativën për depozitimin në Kuvend të një projektligji, i cili synon të bëjë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

Qëllimi i këtij projektligji është shfuqizimi i nenit 62 të këtij ligji, i cili ka të bëjë me vendosjen e një sërë kufizimesh lidhur me zotërimin e pronësisë së kapitalit nga mbajtësi i licencave të transmetimeve audiovizive tokësore.

Ndryshimi i propozuar synon të eliminojë barrierat që në praktikë kanë rezultuar si pengesa reale dhe të panevojshme në zhvillimin e transmetimeve audiovizive në Shqipëri, kanë cenuar seriozisht konkurrencën e ndershme dhe efektive në fushën e tregut të medieve audio dhe audiovizive, si dhe kanë cenuar një nga parimet themelore mbi të cilat AMA duhet të ushtrojë veprimtarinë e saj, pikërisht garantimin e aksesit të barabartë dhe jodiskriminues në tregun e medieve audio dhe audiovizive.

Ndryshimi i propozuar, gjithashtu, synon të eliminojë mbivendosjen e kompetencave ndërmjet dy institucioneve, Autoritetit të Konkurrencës, si struktura e paraparë ligjërisht

kompetente që ka detyrën dhe përgjegjësinë për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 9921 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe AMA-s, e cila është e paraparë si një institucion që, referuar ligjit nr. 97/2013, vepron bazuar në kritere të tjera që bien ndesh me legjislacionin që rregullon mbrojtjen e konkurrencës.

E thënë ndryshe dhe me fjalë të thjeshta, ajo çka ndryshimi i propozuar synon përmes kësaj iniciative ligjore është që çfarë kompetence ka Autoriteti i Konkurrencës është një e drejtë e parashkruar në këtë ligj dhe çfarë të drejtash dhe instrumentesh ka Autoriteti i Medieve Audiovizive janë të drejta të tjera.

Çështjet e konkurrencës në legjislacionin dhe në kuadrin ligjor shqiptar i ka vetëm Autoriteti i Konkurrencës.

Si Komision i Integritimit Europian, si anëtar dhe nënkryetar i tij, si dhe si bashkëkryetar i Delegacionit të Përbashkët Parlamentar (Parlamenti Europian-parlamenti i Shqipërisë), sigurisht, që prej momentit të parë që kam marrë këtë iniciativë kam qenë dhe kam verifikuar rakordimin e këtyre propozimeve me eksperiencat më të mira europiane, sigurisht me legjislacionin parësor dhe dytësor të Bashkimit Europian, ashtu siç konfirmon edhe Njësia e Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend, të cilët i falënderoj për punën shumë të mirë që kanë bërë!

Më lejoni t’ju bëj me dije dhe të citoj pjesë nga raporti i kësaj Njësie, duke lehtësuar edhe punën e ekspertit tonë për këtë rast!

“Për sa i përket legjislacionit parësor, qoftë neni 53, nenet 56-57 (ish-nenet 49-50 të Traktatit të Komunitetit Europian) dhe neni 62 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Europian, qoftë neni 102 “Bashkëpunimi në fushën audiovizuale” i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (BE-Shqipëri) janë baza të shëndosha që justifikojnë këtë ndërhyrje ligjore, por qoftë edhe legjislacioni dytësor i BE-së, direktiva 13/2010 e BE-së, e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 10.03.2010 “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimit me zë dhe figurë” janë baza të përafrimit të një drejtimi të duhur që ne kemi në përafrimin e legjislacionit tonë edhe në këtë kontekst.

Referuar legjislacionit parësor dhe dytësor të BE-së të lartpërmendur, shërbimi i medieve audiovizive konsiderohet shërbim në kuptimin e neneve 56 dhe 57 dhe, si i tillë, ai i nënshtrohet regjimit të përgjithshëm të parashikuar nga ky traktat lidhur me lirinë për të ofruar shërbime. Kjo do të thotë se shtetet anëtare të Bashkimit Europian nuk duhet të kufizojnë ofrimin në territorin e tyre të shërbimeve të medieve audiovizive, transmetime nga

ofrues të shërbimit medietik audioviziv të vendosur në shtetet e tjera anëtare të BE-së për sa kohë që programet e transmetuara nuk janë të një natyre të dhunshme, të cilat cenojnë sensibilitetin e të miturve. Gjithashtu, shtetet anëtare mund të kufizojnë transmetimet e vendosura në shtete të tjera anëtare kur ato kanë vënë në rrezik politikën publike, sigurinë, shëndetin publik, mbrojtjen e konsumatorit” dhe çështje të tjera shumë të rëndësishme.

Si konkluzion, çështjet e lidhura me zotërimin e pronësisë së kapitalit nga mbajtësit e licencave të transmetimeve audiovizive janë aktualisht kompetencë ekskluzive e shteteve anëtare të BE-së dhe për pasojë ato kanë diskrecion dhe pavarësi të plotë në vendosjen e objektivave të politikave të tyre në këtë fushë, si dhe miratimin e normave ligjore që ato i gjykojnë të përshtatshme për rregullimin e këtyre çështjeve. Pra, këto ndryshime të propozuara e rregullojnë këtë çështje plotësisht, të cilat i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë. Për pasojë, Shqipëria ka autoritet, diskrecion të plotë për t’i rregulluar këto çështje në mënyrën që e gjykon të përshtatshme.”

Kush është munduar të vendosë në gojën e Bashkimit Europian kundërshtimin e këtyre projektligjeve, të paktën për sa i përket legjislacionit të BE-së e ka gabim.

Unë mendoj se legjislacioni i ndryshuar është në rakordim të plotë edhe me legjislacionin parësor dhe dytësor të Bashkimit Europian.

Në radhë të parë, jam i hapur për pyetje, se këtu jam subjekt propozues, dhe më pas u kërkoj anëtarëve të Komisionit për Integrimin Europian t’ia kalojmë komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare, në seancën më të shpejtë të mundshme për votim.

Faleminderit!

Majlinda Bregu – Faleminderit, zoti Balla, në lidhje me prezantimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin aktual “Për mediet audiovizive”.

Unë nuk besoj se duhet t’i hyjmë diskutimit në detaje tani, por kolegët janë të lutur të bëjnë pyetje dhe komente, nëse kanë. Ne nuk jemi komision përgjegjës për ligjin, pra jemi komision i cili do të japë mendim dhe, duke qenë se e drejta e mediejeve audiovizive dhe ofrimi i shërbimeve janë të lidhura ngushtësisht edhe me legjislacionin e Bashkimit Europian, por e vërtetë është ajo që tha Taulanti pak më parë, se çdo vendi i lihet e drejta, pra janë të lirë për të vendosur dhe për ta rregulluar sipas normave ligjore që i shqyrtojnë dhe i gjykojnë si të përshtatshme, mendimi i Njësisë së Përafrimit të Legjislacionit në Kuvend është që ky projektligj rregullon çështje që i përkasin vetëm legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, ndaj Shqipëria ka të drejtë t’i vlerësojë dhe të miratojë ato çështje që i mendon si më të përshtatshme.

Ndërkohë, zoti Kasneci, referuar legjislacionit parësor dhe atij dytësor të Bashkimit European, si dhe Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (BE-Shqipëri) në nenin 102 “Bashkëpunimi në fushën audiovizuale”, ndryshimet e propozuara nga zoti Balla janë në përputhje?

Dedë Kasneci – Sikurse u prezantua, në fushën e medieve audiovizive ekziston direktiva, si dhe legjislacioni parësor dhe dytësor. Ky është shërbim në kuptimin e legjislacionit të Bashkimit European, por në kuptimin e ngushtë të nenit konkret “Rregullimi i pronësisë”, për çështjet që lidhen me rregullimin e pronësisë dhe transmetuesit audiovizuale nuk ekziston asnjë normë e cila e rregullon këtë.

Në momentin që nuk ekziston legjislacion parësor dhe dytësor, shtetet anëtare kanë diskrecion të plotë për të rregulluar...

Majlinda Bregu – Doni të thoni se Taulanti nuk ka bërë asnjë gabim këtë radhë dhe e ka të qartë? E kuptova. Faleminderit!

Dedë Kasneci – Faleminderit!

Majlinda Bregu – Atëherë, ka ndonjë pyetje për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2013 "Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i propozuar nga zoti Balla, para se të fillojmë me ministren? Jo?

Siç duket ju ka qartësuar më parë zoti Balla në komision.

Atëherë, kalojmë në votimin e ligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.97/2013 "Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Kush është dakord?

Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Ne nuk marrim pjesë në votim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 05.05.2015, ora 18:15

Drejton mbledhjen:

Majlinda Bregu – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me zonjën Klajda Gjoshë.

Kalendari i punimeve të Komisionit për Integrimin Europian për periudhën 1-22 maj 2015.

Marrin pjesë:

Majlinda Bregu, Esmeralda Shkaj, Ilir Xhakolli, Taulant Balla, Bujar Derveni, Edi Paloka, Sadri Abazi dhe Gerti Bogdani.

Mungojnë:

Arben Imami, Gramoz Ruçi dhe Kejdi Mehmetaj.

E ftuar:

Klajda Gjoshë – ministre e Integritimit Europian.

Ilirjan Xhezo – drejtor i Politikave Sektoriale në Ministrinë e Integritimit Europian.

Altin Fuga – drejtor i Sekretariatit për Çështjet Europiane në Ministrinë e Integritimit Europian.

Majlinda Bregu – Fillojmë me ministren, të cilën e falënderojmë për ardhjen në komision, pavarësisht se e ndryshuam orarin e takimit të sotëm në komision për hir të ceremonive me rastin e 5 Majit.

Ju falënderoj edhe një herë për gatishmërinë dhe besoj se kemi shumë gjëra për të diskutuar.

E para, me ligjin e ri “Për forcimin e rolit kontrollues të parlamentit në procesin e integritetit”, qeveria dhe Ministria e Integritetit, duke nisur që nga Kryeministri i vendit, kanë disa detyra dhe data të mirëpërcaktuara për raportimin në parlament, i cili pavarësisht faktit se ligji nuk ka hyrë në fuqi në janar të këtij viti, përcakton detyrimet duke filluar nga fillimi i vitit, ndaj, do t’ju lutesha, duke ju rikujtuar për të zbatuar detyrimet e ligjit të ri, njëkohësisht, duke i përcjellë një kujtesë edhe Kryeministrit për detyrimet që ka në këtë proces për të raportuar para Kuvendit, të na përcillni sa më shpejt Planin Kombëtar për Integrimin Europian dhe legjislacionin, paketën ligjore apo e thënë ndryshe, inventarin e ligjeve, që qeveria mendon se duhet të miratojë deri në fund të këtij viti.

Ka dhe një sërë raportimesh të tjera, të cilat kanë të bëjnë edhe me udhërrëfyesin dhe zbatimin e 5 detyrimeve dhe prioritetëve që ka Shqipëria përpara, në rrugën e Integrimin Europian.

Duke qenë se muaji janar kaloi dhe tashmë jemi në muajin maj dhe ligji ka hyrë në fuqi diku nga fund i shkurtit, edhe një herë ju lutem, të paraqisni sa më shpejt raportin e detajuar mbi zbatimin e detyrimeve dhe të gjitha aktet që mendoni të miratoni deri në fund të vitit. Thënë kjo, ka nevojë jo vetëm për Komisionin e Integritetit, por ka rëndësi edhe për Këshillin Kombëtar të Integritetit pasi ky këshill do të ketë një axhendë, e cila do të funksionojë mbi kontrollin dhe monitorimin e atyre detyrimeve që qeveria shqiptare ka në proces.

Atëherë, fillojmë. Ka mbaruar Komiteti i Stabilizim-Asociimit dhe jemi përpara Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

Ka mbaruar me kohë progres-raporti dhe jeni gati për t’ia paraqitur inputin e ri KE-së. Ndërkohë, janë detyrimet e përditshme të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe çfarë është më e rëndësishmja, udhërrëfyesin për 5 prioritetet.

Unë s’e di nëse Ministria e Integritetit ka bërë ndonjë analizë të hollësishme për masat e plotësuara në secilin prioritet.

Do t'ju lutesha të bënit një prezantim të përmbledhur, duke pasur parasysh edhe kohën që kemi në dispozicion dhe pastaj, t'u linim më shumë kohë kolegëve për të bërë pyetje, sepse jam e bindur që do të dalin çështje për të cilat mund ta rimerrni më pas fjalën për t'u përgjigjur, edhe po t'ju mbeten mangët gjatë prezantimit.

Faleminderit!

Klajda Gjoshaj – Ju falënderoj për ftesën, zonja kryetare e komisionit!

Kam ardhur me shumë kënaqësi sot, në Komisionin e Integritit për të raportuar mbi ecurinë që ka pasur Shqipëria edhe gjatë muajve të fundit, që nga hera e fundit që unë kam qenë në komision. Patjetër, ne, në asnjë moment nuk kemi pritur miratimin e ligjit “Për forcimin e rolit të parlamentit në procesin e integritit”, i cili u miratua pak muaj më parë nga Kuvendi, për të raportuar në komision, sepse në përgjithësi Ministria e Integritit ka qenë shumë e rregullt në raportimin e dokumenteve bazë që ne prodhojmë, por dhe në ecurinë e procesit. Ne gjithmonë respektojmë edhe afatet.

Në këtë moment që flasim, kemi bërë një analizë të hollësishme të udhërrëfyesit të 5 prioriteteve dhe ecuria ka qenë mjaft e mirë. Mund t'ju themi se deri në këto momente, kemi një realizim prej 88% të masave të vendosura në udhërrëfyesin e 5 prioriteteve, duke qenë ky një dokument zyrtar dhe i aksesueshëm nga të gjithë dhe kështu, është lehtësisht i verifikueshëm. Ky është një monitorim i bërë jo vetëm nga Ministria e Integritit, por edhe nga grupet e përbashkëta të punës, që siç e dini, janë ngritur nga shtatori i vitit 2014. Këto grupe përbëhen nga përfaqësues të ministrive përkatëse këtu, në Shqipëri, por edhe nga përfaqësues të KE-së. Pra, nuk jemi vetëm, por monitorohemi shumë ngushtë edhe nga vetë KE-ja në këtë proces.

Sa u përket të gjitha këtyre realizimeve, për të cilat unë do të flas edhe pak më poshtë, janë të detajuara dhe të raportuara edhe në dialogun e nivelit të lartë, i cili u realizua vetëm 1 muaj më parë me komisionerin e ri Hahn, ku u vlerësua i gjithë procesi i integritit të Shqipërisë, madje u inkurajua për të gjitha reformat që po ndërmerret qeveria për ta çuar më përpara procesin, pse jo, edhe në pritshmëritë që kemi për të marrë një rekomandim nga vetë Komisioni Europian në vjeshtën që vjen.

Sot kemi dorëzuar edhe inputin e parë të qeverisë shqiptare sa i përket progres-raportit dhe pjesa përfundimtare do të dorëzohet në shtator (afati i fundit që kemi), në mënyrë që KE-ja të ketë kohën për të vlerësuar të gjithë raportimin, që ka bërë Ministria e Integritit.

Më lejoni ta nis me prioritetin e parë, reformën në administratën publike. Kjo është një nga reformat më të suksesshme deri në këto momente dhe është theksuar edhe në rezolutën e raportuesit për Shqipërinë, zotit Flekenshtajn, e miratuar pak ditë më parë, në pikën ku ai flet për administratën publike, mirëpret faktin se ligji i ri “Për shërbimin civil” ka filluar të zbatohet dhe njëkohësisht inkurajon finalizimin e një strategjie të reformës në administratën publike.

Mund t’ju them se strategjia e reformës në administratën publike tashmë ka përfunduar dhe është tashmë një dokument tepër i rëndësishëm, sepse do të na lejojë ne të gjithëve dhe në fakt Shqipëria do t’i jepet mundësia të financohet në këtë fushë, duke qenë se e ka të përfunduar këtë strategji.

Ka filluar zbatimin ligji i ri “Për nëpunësin civil” me miratimin e 10 akteve nënligjore. Është ngritur institucioni i Komisionierit të Shërbimit Civil, i cili po forcohet në burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare, në mënyrë që të vihet në zbatim. Aktualisht Departamenti i Administratës Publike po punon për një sistem elektronik që mbledh të dhënat e personelit të institucioneve publike dhe ka përgatitur një projekt-strategji të trajnimeve dhe planin e trajnimeve për vitin 2015 për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Është realizuar rekrutimi i parë në grup për 113 vende vakante të nivelit specialist, ku mbasi janë marrë 5100 aplikime *online*, janë kualifikuar 1900 kandidatë dhe janë shpallur 38 fitues.

Sa i përket prioritetit të dytë dhe reformës në drejtësi, patjetër ky është një prioritet më i komplikuar, që kërkon kohën e vet dhe unë mund t’ju them se shumë prej masave tashmë të përealizuara i përkasin këtij prioriteti, sepse janë pjesë e reformës në drejtësi në tërësi dhe pritet koha e duhur që ato të realizohen.

Kam bindjen se edhe Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi është duke funksionuar mjaft mirë. Këtë e ka pohuar edhe vetë komisioneri Hahn, i cili ka përgëzuar Shqipërinë jo vetëm për ndërmarrjen e kësaj reforme, por edhe për punën e bërë deri tani.

Është dorëzuar një dokument, një plan aksioni pranë KE-së, me të gjitha detajet e duhura për vazhdimësinë e reformës, i përgëzuar edhe ky kështu që puna për reformën vazhdon dhe ne shpresojmë se do të kemi një finalizim brenda tetorit të këtij viti.

Ka pasur një përmirësim të bazës ligjore për adresimin e prioritetit të dytë dhe janë miratuar një sërë ligjesh të rëndësishme. Është dorëzuar drafti i ligjit “Për avokaturën e shtetit” pranë Këshillit të Ministrave dhe do të miratohet së shpejti.

Për më tepër, në kuadër të përmirësimit të bazës ligjore është riaktivizuar grupi i punës për rishikimin tërësor të Kodit të Procedurës Penale, nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe me asistencën e EURALIUS-it dhe me përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara. Është përfunduar edhe drafti i parë i projektligjit “Për sistemin e vlerësimit të gjyqtarëve”, i cili është dërguar tashmë për mendim.

Sa i përket luftës ndaj korrupsionit, mund t’ju them se gjatë kësaj periudhe janë bërë një sërë arritjesh të rëndësishme në kuadër të përmirësimit të bazës ligjore për adresimin e këtij prioriteti dhe më 20 mars është miratuar strategjia kombëtare kundër korrupsionit, që ishte një nga rekomandimet kryesore të rezolutës të miratuar në PE, si dhe ligji “Për mbrojtjen e informatorëve të rasteve të korrupsionit”, i cili pritet të miratohet në qershor të këtij viti.

Me qëllim raportimin dhe gjurmimin në kohë reale të rasteve të korrupsionit, është ngritur dhe është bërë funksional tashmë, edhe një sistem *online* për rastet e korrupsionit dhe si pasojë e këtij portali është vënë re një rritje e ndjeshme e ankesave të regjistruara, të cilat po ndiqen nga të gjitha institucionet përgjegjëse.

Në kuadër të parandalimit të korrupsionit është konsideruar i rëndësishëm roli i ILDKPI-së. Në vijim të ndryshimeve ligjore që janë bërë me synimin e përmirësimit të kontrollit të pasurive, në kuadër të luftës kundër korrupsionit ka pasur një rritje të konsiderueshme të numrit të zyrtarëve të kontrolluar nga ILDKPI-ja, si dhe ka pasur një rritje të masave të tjera administrative dhe kallëzimeve penale pranë prokurorisë.

Në kuadër të ndëshkimit të korrupsionit, është synuar hetimi dhe goditja e veprimeve korruptive në sektorët e shërbimit publik, si dhe rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional. Gjithashtu, janë përmirësuar kapacitetet për hetimet proaktive dhe përdorimin e metodave speciale të hetimit për rastet e korrupsionit dhe krimeve të zyrtarëve të lartë në detyrë.

Sa i përket prioriteti të katërt, lufta ndaj krimit të organizuar, mund t’ju them se është theksuar edhe nga KE-ja një trend pozitiv në luftën ndaj krimit të organizuar dhe në këtë kuadër, Policia e Shtetit i është nënshtruar një procesi reformimi, i cili synon përafrimin dhe përmirësimin e standardeve të organizimit dhe funksionimit të shërbimit

policor. Gjithashtu, baza ligjore është përmirësuar, duke e sjellë më afër standardeve europiane.

Operacionet në nivel ballkanik janë zhvilluar nën drejtimin apo organizimin e Qendrës SELEC raportohet edhe për luftën kundër kultivimit të kanabisit, si edhe të parandalimit, reduktimit të prodhimit të tregtisë dhe shpërndarjes së drogës. Përpjekjet e bëra në këtë fushë janë vlerësuar edhe nga raporti i fundit i Departamentit Amerikan të Shtetit, i cili vlerëson se rastet e evidentuara në luftën kundër narkotikëve dhe arrestimet janë të ndjeshme.

Strategjia kundër trafikimit tashmë është miratuar, duke treguar angazhim maksimal në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, pastrimit të parave dhe zbatimit efektiv të ligjit “Antimafia”.

Për sa i përket luftës kundër terrorizmit është ngritur drejtoria Antiterrorizëm. Është rritur ndjeshëm bashkëpunimi midis Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda në kuadër të luftës së terrorizmit.

Për prioritetin nr.5, për të drejtat e njeriut janë shënuar një sërë arritjesh në luftën kundër diskriminimit, me ndryshimet e bëra edhe në Kodin Penal që rrisin ndëshkimet për krimin e urrejtjes në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. I referohem rezolutës, e përmendur këtu edhe nga zoti Frankershtain, sepse është një tregues i qartë i masave të ndërmarra për prioritetin nr.5, ku duhet të theksoj miratimin e ligjeve për të drejtat e njeriut dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgim, për Policinë e Burgjeve, për strategjinë e të miturve 2015-2010 e kështu me radhë.

Në fushën e të drejtave të fëmijëve është miratuar rezoluta dhe plani i veprimit për të drejtat e fëmijëve.

Për sa i përket barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje është prezantuar sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve për të monitoruar rastet e dhunës në familje. Janë caktuar koordinatorët për çështjet gjinore në çdo ministri të linjës.

Në lidhje me të drejtat e komunitetit LGBT, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile është përmirësuar, është nënshkruar deklarata e angazhimit në kuadrin e Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë.

Në lidhje me të drejtat e minoriteteve pas seminarit të muajit shkurt të vitit 2014 ka nisur puna e grupit ndërministror për të hartuar një plan veprimi për integrimin e romëve dhe egjiptianëve për periudhën 2015-2010.

Këto janë disa nga masat që Shqipëria ka raportuar edhe pranë Komisionit European, ku ka pasur edhe një vlerësim të këtij të fundit. Nuk mund të themi se kemi plotësuar të gjitha kërkesat e ardhura nga BE-ja apo detyrimet që ka Shqipëria për procesin e integritimit dhe jo vetëm për të çuar më tej zhvillimin e vendit, por jemi të gatshëm të vazhdojmë me të gjitha forcat dhe vullnetin tonë, të qeverisë dhe të aktorëve kryesorë për të vazhduar me sukses në rrugën e procesit të integritimit.

Faleminderit.

Majlinda Bregu - Zonja Ministre, faleminderit!

Në fakt, me kaq optimizëm sa e pasqyroni ju situatën, i bie që ne në progresraportin e muajit tetor, nëse Komisioni European nuk na hap negociatat, atëherë, duhet të keni ndonjë problem me ata, sepse ne i kemi plotësuar të gjitha detyrimet. Nuk ka mbetur gjë pa u plotësuar. Megjithatë, do të hap tani arenën e pyetjeve dhe të komenteve, të cilat besoj se nuk do të jenë pak, por nisur nga fjala juaj, ku thatë se keni përcjellë sot për në Bruksel imputin për raportin e progresit, po ju citoj edhe një herë ligjin e ri, të cilin duhet t'jua kishin sjellë në vëmendje këshilltarët tuaj, para se të mbërrinit sot. Jeni të detyruar të paraqisni në Kuvend, në Komisionin e Integritimit të gjitha raportimet e paraqitura pranë strukturave të Komisionit European përpara se t'i paraqisni te ky i fundit. Pra, përpara se komisioneri Han apo raporterit për Shqipërinë të lexojë se çfarë ka bërë Shqipëria këtë muaj, duhet t'i lexojmë ne këtu një herë të gjithë. Ndoshta na lind ndonjë ide më e mirë sesi ta bëjmë këtë proces më mirë të gjithë bashkë, sepse është detyrim i të gjithëve, i qeverisë, por duhet të jetë gjithëpërfshirës.

Komenti i dytë përpara se të kaloj te pyetjet, në lidhje me planin e veprimit apo udhërrëfyesin, i cili duhet të konsultohet me shoqërinë civile, me grupet e interesit, nuk e gjeta të publikuar në faqen e *web-it* të Ministrisë së Integritimit, gjë që do të thotë për mua se ka ndonjë problem, ka ndonjë gjë që nuk doni ta bëni publike, apo nuk keni mundësi ta *update*-oni, meqenëse çdo ditë e plotësoni me ndonjë arritje të re, apo janë shumë arritje dhe nuk keni vend në faqen e *web-it* të ministrisë?

Ju lutem, në fillim të marrim pyetjet dhe pastaj mund të përgjigjeni me radhë.

Në rast se kolegët kanë pyetje, do të ishte mirë të grumbulloni disa pyetje, sepse mund të ketë përsëritje me njëra-tjetrën. Unë i rezervoj të drejtën vetes për të bërë përsëri disa pyetje, por pas kolegëve që të jenë më gjithëpërfshirëse si pyetje.

Faleminderit! Po, zoti Bogdani.

Gerti Bogdani - Jam dakord me zonjën Bregu, kur thotë se duke dëgjuar arritjet e paraqitura, normalisht në progresraportin e tetorit duhet të kemi një mesazh pozitiv për hapjen e negociatave, nëse ky është realisht realiteti shqiptar.

Lajm i mirë është edhe kjo që ju përmendët, reforma në administratën publike: 138 vende specialistësh të punësuar në grup, është një hap shumë i rëndësishëm dhe shumë i madh përpara drejt punësimit të 300 mijë shqiptarëve. Pyetja që kam është, a mendoni se progresraporti i muajit tetor, kur ju përmendni Policinë e Shtetit në proces reformimi, besoj se keni parasysh rastet e Korçës, të Kavajës, gruan e dhunuar të “21 dhjetori” në Tiranë apo rastin e djeshëm në Kukës? A mendoni se kjo do të ndikojë negativisht në reflektimin e këtij procesi të reformuar të policisë që ju doni, por nuk besoj se duan shqiptarët? Kur flisni për luftën kundër krimit të organizuar, a besoni se rastet e deputetëve Doshi dhe Frroku do të ndikojnë në progresraportin e muajit tetor?

Besoj se arritje shumë e madhe është nënshkrimi i rezolutës dhe i deklaratës për 17 majin, edhe për të drejtat e njeriut kundër diskriminimit, por kam përshtypjen se të drejtat e njeriut në përgjithësi në Shqipëri janë duke u shkelur çdo ditë, siç tregon rasti i djeshëm i Kukësit, rasti më i freskët, sepse raste të tilla janë pa fund. A mendoni se këto do të ndikojnë negativisht në progresraportin e tetorit të vitit 2015?

Majlinda Bregu – Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Paloka.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti mund të bësh një pyetje, pastaj në bazë të përgjigjes, të japim të drejtën të bësh një pyetje tjetër.

Edi Paloka – Zonja Ministre, kryetarja e komisionit na e dogji një pyetje, po mesa kuptova nga raportimi juaj me gjithë këto arritje që kemi, mendoj se jemi shumë afër hapjes së negociatave, a mendoni edhe ju kështu, përderisa kemi vetëm arritje, hapja e negociatave në shtator apo në tetor është një fakt i kryer?

Më pas do të bëj edhe pyetje të tjera që lidhen me disa strategji që janë paraqitur së fundi nga njerëz kryesorë në qeveri lidhur me integrimin.

Unë do të doja t’ju pyesja ju, nëse e shikoni si të arsyeshëm qëndrimin e Shqipërisë ndaj Europës, kur i bëjmë presion Europës me forma të tilla, si për shembull nëse nuk na pranoni, Shqipëria rrezikon të bëhet vend strehimi për terroristët apo nëse nuk na pranoni, Shqipëria bashkohet fizikisht me Kosovën?

Mund të jetë pjesë e kësaj pyetjeje ose veç, çfarë mendimi keni ju si ministre e Integritimit, kush ka më tepër nevojë: ne për Europën, apo Europa për ne? Kryeministri mendon se të dyja palët kemi nevojë njëlloj, nëse edhe ju mendoni kështu, a mendoni se duhet t'i vëmë edhe ne kushte Europës që të na pranojë?

Faleminderit!

Majlinda Bregu – Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zonja Ministre, në një analizë të bërë, meqenëse ju përmendët pak më parë edhe ekspertë, të cilët ndjekin dhe monitorojnë procesin e integritimit. Në një analizë të bërë nga SIGMA, rezulton se për vitin 2014 janë përafuar vetëm 91 akte ligjore nga 202 të parashikuara në planin kombëtar të integritimit. Këto statistika, sipas mendimit tuaj, flasin për një vullnet shumë të madh dhe seriozitet të qeverisë në zbatimin e detyrimeve në procesin e integritimit, duke respektuar edhe afatet apo për një proces, i cili është i ngadaltë, i vonuar dhe që i mungon ndarja e përgjegjësisë të saktë? Mos harroni se Kuvendi dhe ky komision punon dhe e ka alfën e punës atë legjislacion dhe projektligjet që propozohen nga Këshilli i Ministrave. E thënë ndryshe, nga analiza që ka bërë Kuvendi rezulton se vetëm 42 projektligje të miratuara kanë pasur përaftrim të plotë dhe po t'ju kujtoj këtu edhe një koment të zotit Ruçi në mbledhjen e datës 14 dhjetor të vitit 2013, ju nuk duhet të pranoni asnjë projektligj, vetëm që kjo ka qenë traditë dhe rregull në qeverinë e mëparshme, por ju nuk duhet të pranoni asnjë projektligj, i cili nuk vjen me përaftrim të plotë me *Acqui-n*, sepse përndryshe vijnë ato ligje që janë në shkelje, vijnë paketa si ajo e sistemit të drejtësisë, ku ju kaloni pjesë ligjesh vetëm për interesa të ngushta politike, vijnë ato ligje që e bëjnë reformën në drejtësi sot edhe në deklaratë edhe në kuotat edhe në gjykimin e Komisionit European të copëzuar. Ende nuk kemi parë asnjë strategji të plotë të reformës në drejtësi që të dimë kur fillon, ku mbaron, sa akte ligjore përafrohen, sa kushton, sa gjykatës i duhen këtij vendi, sa gjykata të reja i duhen, sa gjykata që janë nuk duhen, sa “*Gate*” ka në sistemin e drejtësisë dhe, përveç luftës kundër korrupsionit, si do të punoni me ta, sepse duhet një dokument që të përfshijë edhe objektivat, edhe afatet, edhe të gjitha detyrimet tjera.

Do të doja që në përgjigjen tuaj t'i kushtonit vëmendje pjesës së kapacitetit të administratës publike. Në rast se me të vërtetë udhërrëfyesi është plotësuar në nivelin që ju deklaroni, atëherë, a ka gati Shqipëria një grup negociator? Se mund të na lajmërojë në tetor do të hapen negociatat. A e kemi gati ne se kush do t'i bëjë negociatat?

Faleminderit!

Klajda Gjosh – Po e nis me komentim për sa i përket udhërrëfyesit. Unë do t'ju ftoja jo vetëm ju personalisht, por të gjithë, edhe mediet që të kontrollojnë faqen e Ministrisë së Integritimit dhe të zbulojnë se udhërrëfyesi ndodhet aty, të zbulojnë se është konsultuar jo vetëm me shoqërinë civile, por madje është konsultuar edhe me Komisionin e Integritimit, para se të miratohej dhe para se të bëhej dokument zyrtar.

Kështu që unë besoj se nuk është një çështje për t'u ngritur, për t'u bërë kaq e madhe e për të thënë se çfarë është udhërrëfyesi dhe si e plotësoni, sepse aty është me data, janë masa të përcaktuara mjaft mirë në udhërrëfyes dhe është mjaft mirë i aksesueshëm nga të gjithë ju.

Për më tepër, unë e përmenda edhe në fjalën time, që udhërrëfyesi nuk monitorohet vetëm nga pala shqiptare, apo nga Ministria e Integritimit apo nga Komisioni i Integritimit, ju e dini mjaft mirë që monitorimi bëhet shumë i saktë edhe nga vetë Komisioni Europian, që monitoron çdo hap jo vetëm të udhërrëfyesit, por të çdo gjëje, në fakt, që ndodh në vend dhe të çdo vendimmarrjeje që ka Shqipëria.

Majlinda Bregu – E hapim tani zonja Ministre dhe do të shohim të gjithë bashkë që nuk ka asnjë informacion për zbatimin e prioriteteve.

Klajda Gjosh – Ju lutem, mund ta shikojnë të gjithë, nuk është diçka për t'u fshehur. Nuk besoj sot shqiptarët të jetojnë në vitet...

Majlinda Bregu – Jo, është çështje transparence.

Klajda Gjosh – Kështu që mund ta kontrollojnë pa asnjë lloj problemi.

Për sa i përket progresraportit, ju, zonja kryetare, dhe ju, zoti Bogdani, përmendët që me gjithë këtë arritje, Shqipëria meriton të hapë negociatat. Patjetër që ka arritje. Në fjalën time unë citova që Shqipëria ka ende shumë punë për të bërë dhe janë një sërë masash, të cilat priten të ndërmerren nga qeveria bashkë me ju, bashkë me të gjithë aktorët kryesorë të procesit për ta çuar procesin përpara.

Ajo çka ne do të mirëprisnim në tetor, patjetër do të ishte një rekomandim pse jo nga Komisioni Europian, dhe këtë e themi me bindje, bazuar edhe në realizimin e masave të kërkuara nga vetë Komisioni Evropian. Më pas i gjithë procesi i integritimit, patjetër që është shumë i ndërvarur nga procesi i reformave që merr vendi, nga procesi i implementimit të këtyre reformave dhe në të njëjtën kohë paralelisht edhe nga klima e zgjerimit të të gjitha vendeve anëtare.

Pra, janë dy procese paralele, të cilat komplimentojnë njëra- tjetrën dhe në asnjë moment nuk mund t'i quajmë të pandara. Ajo çka neve na intereson, janë pikërisht arritjet që

ka pasur Shqipëria gjatë kësaj kohe për t'i raportuar ato sa më mirë, pse jo për të marrë edhe një rekomandim në tetorin e vitit 2015.

Të gjitha këto reforma, si reforma në Policinë e Shtetit, si të gjitha masat e ndërmarra që kemi organizuar ne dhe të Drejtat e Njeriut, janë pjesë e këtij progresraporti, janë mirëpritur nga Komisioni European dhe do të citohen në progresraport si arritje që ka pasur Shqipëria.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Komentet nga Komisioni European nuk janë aq të fshehura. Kemi pasur takime të njëpasnjëshme në Komisionin European, ka pasur disa deklarata nga komisioneri Han, por edhe nga të tjerë persona përfaqësues të komisionit dhe jam e bindur se shqiptarët e dinë që Shqipëria është në rrugën e duhur për sa u përket reformave dhe procesit të integrimit.

Zoti Paloka bëri një pyetje për sa i përket hapjes së negociatave. Procesi i integrimit nuk është një proces ku ne mund të vendosim data. Është e pamundur që unë mund të them sot se Shqipëria do të marrë një rekomandim në tetor apo jo, pavarësisht dëshirës jo vetëm personale, por të të gjithë shqiptarëve. Është një proces i ndërthurur nga reformat, është një proces i ndërthurur dhe me klimën favorizuese apo jo, për zgjerim të të gjitha vendeve anëtare, të cilat kanë të drejtën e votës për Shqipërinë, për hapjen e negociatave, por edhe më tej në procesin e integrimit.

Kështu që, unë nuk mund t'ju them sot, nëse Shqipëria do t'i ketë dyert e hapura për negociata, por ajo çka them me bindje është se jemi në rrugën e duhur dhe ka pasur një sërë hapash tejet pozitivë jo vetëm për t'iu përgjigjur procesit, por hapa që, në fakt, u shërbejnë të gjithë qytetarëve shqiptarë.

Për sa i përket qëndrimit ndaj Europës, unë e di që ka pasur disa polemika apo edhe fjali të nxjerra nga konteksti. Shqipëria ka vetëm një qëndrim, atë të procesit të integrimit për t'u bërë pjesë e plotë dhe me të drejta të plota në Bashkimin European. Ky është i vetmi prioritet që ka qeveria, kryesori dhe baza e çdo gjëje mbi të cilën ne ndërtojmë punën. Unë them se është përgjigjja më e mirë e të gjitha atyre qëndrimeve që mund të lexohen me këndvështrime të ndryshme.

Kam edhe një pyetje që ka drejtuar zoti Paloka dhe që i përket nevojës që kemi ne për Europën apo Europa për ne. Nevoja që ka Shqipëria për Europën kjo është e padiskutueshme dhe për vetë procesin e integrimit. Pastaj për pjesën e dytë të pyetjes, pse jo, edhe Europa ka nevojë për Shqipërinë, në fakt, për të mbyllur dhe finalizuar një projekt të

madh të nisur prej vitesh dhe nuk mund të ketë një Europë të bashkuar pa Shqipërinë në BE, dhe në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Kjo është e pandalshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Majlinda Bregu - Zoti Bogdani ka të drejtë të presë përgjigjet e tij, sepse ishin dy pyetje konkrete, që kishin të bënin me rastet e dhunimit të të drejtave të njeriut dhe të shkeljes nga Policia e Shtetit dhe me raste konkrete, referuar me rastit të Korçës, të Kukësit si edhe të lufta kundër krimit të organizuar me një nga proceset kryesore, që ju e dini që është dekriminalizimi. Unë besoj që...

Klajda Gjasha – Unë iu përgjigja pyetjes së zotit Bogdani, ku për të dyja çështjet ka pasur shumë arritje dhe të gjitha reformat janë mirëpritur. Unë e di që çështja dhe theksi është te dekriminalizimi. Çdo gjë është në proces, komisioni t'i shqyrtojë të gjitha idetë që ka dhe ne jemi të gatshëm për t'i shkuar deri në fund kësaj çështjeje, jo për t'i raportuar Komisionit Europian, por sepse është diçka e nevojshme për parlamentin shqiptar dhe për të gjithë shqiptarët.

Gerti Bogdani – Sa për sqarim të pyetjes, se mbase nuk u kuptuam.

Pa diskutim që procesi i dekriminalizimit është një nga proceset më të rëndësishme dhe rezoluta e dhjetorit nuk do të ishte votuar në parlamentin e Shqipërisë nëse nuk do të kishte një presion të konsiderueshëm nga Parlamenti Europian, duke përfshirë dy grupet e mëdha politike, qoftë të majtën europiane, qoftë partitë popullore europiane, sepse mesa dukej, vullneti në Shqipëri nuk ishte, këtë e tregon edhe ecuria, mungesa e vullnetit për ta filluar këtë proces që me zgjedhjet lokale të 21 qershorit.

Sidoqoftë, pyetja tjetër ishte shumë më specifike për Policinë e Shtetit. Ju përmendët arritjet në reformimin e Policisë së Shtetit, të pasqyruara në progresraportin e mëparshëm. Pyetja ime ishte për rastet që kanë ndodhur pas këtij progresraporti, si rasti i Korçës, rasti i Kavajës, gruaja që dhunohet nga dy policë të 21 Dhjetorit në Tiranë, dhe së fundi, rasti i Kukësit, ku kemi shefin e Krimeve të Policisë së Shtetit, i veshur civil, duke karikuar pistoletën e tij, dhe më pas dhunon një qytetar duke e futur në furgon. Këto janë raste që kanë ndodhur dhe në javët e fundit pas progresraportit.

Pyetja ishte shumë konkrete: a mendoni se këto do ta cenojnë dhe do ta dëmtojnë këtë frymë pozitive ose këtë përshkrim pozitiv të reformimit të Policisë së Shtetit që është paraqitur në progresraportin e fundit?

Klajda Gjasha – Zoti Bogdani, për sa i përket reformës në Policinë e Shtetit, është një nga reformat më të suksesshme që ka ndërmarrë qeveria. Rastet që ju përmendët, patjetër

që janë tejet të vështira për t'u përballur, por ajo çka duhet thënë është se ato ndiqen një më një dhe kjo është shumë e rëndësishme. Ndjekja e tyre do të jetë pjesë e progresraportit dhe kjo, në fakt, është edhe më e rëndësishme, sepse tregon mirëfunksionimin e shtetit dhe zbatimin e ligjit.

Majlinda Bregu – Dakord.

Zoti Balla.

Edi Paloka – Ke pyetje? Në qoftë se ke pyetje, në rregull. Unë nuk kam marrë përgjigjet e mia.

(Diskutime pa mikrofon.)

Majlinda Bregu – Në rregull, nuk i kemi mbyllur pyetjet.

Taulant Balla – Ka një rregull bazë. Ministrja nuk ka ardhur në Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike për të dhënë përgjigje, ka ardhur në komision dhe sigurisht që fjala alternohet me përfaqësuesit e opozitës dhe përfaqësuesit e maxhorancës. Unë kam pyetjet dhe rregullimet, le të themi. Më vjen keq që tentativa për të keqpërkthyer një fjali të Kryeministrit të Shqipërisë nga Kryeministri serb, Vuçiç, dhe mediat serbe, nuk kuptohet në shqip nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe nga Partia Demokratike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta mbaroj, ju lutem!

Sot në Kuvendin e Shqipërisë, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike flet si Kryeministri i Serbisë dhe jo si kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

(Diskutime pa mikrofon.)

Majlinda Bregu – Taulant, të lutem!

Edi Paloka – Zonja kryetare, ky zotëria është mësuar të bëjë këto deklaratë, por i ka bërë me të tjerët, me mua bën mirë të mendohet.

(Diskutime pa mikrofon.)

Jo, nuk je duke folur te Edi Rama këtu, se je mësuar që merr urdhrat e atij.

Majlinda Bregu – Mos e ekzagjeroni gjuhën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flasin vetë zotërinjtë, s'ka nevojë t'i dalë njeri në krah.

S'mund t'u thuash shqiptarëve...

(Mungesë incizimi.)

Taulant Balla - ...që bashkimi ynë më Kosovën ndodh vetëm në kuadër të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë dhe jemi të bindur, ashtu sikurse e tha edhe zonja

ministre, që Shqipëria dhe Kosova janë pjesë e një procesi integruar të përbashkët dhe do të bashkohen një ditë vetëm në kuadër të Bashkimit Europian, sikurse është e pavend të bësh pyetjen: na do BE-ja ne apo e duam ne BE-në?

Ne e duam BE-në, sepse është aspiratë historike e shqiptarëve, e iniciuar prej vitit 1993 me shpejtësitë dhe me ulje-shpejtësitë sipas kohëve të caktuara dhe, sigurisht, shqiptarët përsëri mbeten populli që e do BE-në më shumë se çdo popull tjetër i angazhuar në këtë proces. Për fat të mirë, ende 97% e qytetarëve shqiptarë shprehin dhe besojnë që rruga e duhur për Shqipërinë është rruga drejt Bashkimit Europian dhe ne si maxhorancë jemi të interesuar totalisht që këtë rrugë të duhur të shqiptarëve drejt BE-së ta vazhdojmë, ashtu sikurse jemi të bindur, që rruga e duhur drejt BE-së ka stacionin e radhës hapjen e negociatave.

Hapja e negociatave bëhet e mundur përmes plotësimit të detyrave të shtëpisë, të cilat, zonja ministre e tha, këtu nuk është çështja nëse je optimist apo pesimist. Ne jemi optimist që përmbushja e reformës gjyqësore, reforma të shëndosha në Policinë e Shtetit, reforma të shëndosha në çështjet e respektimit të të drejtave të njeriut, reformat në administratën publike dhe çdo reformë tjetër është drejtimi i duhur i shqiptarëve për integrim europian.

Realisht ju them, nuk dua të bëj keqpërdorim politik, por nuk e gjej me vend që në Kuvendin e Shqipërisë të bëhen pyetje për interpretim të deklaratave, që kanë të bëjnë me diçka që asnjë shqiptar nuk e ka kuptuar ndryshe, përveç atyre që e keqinterpretuan në Beograd.

Faleminderit!

Majlinda Bregu – Zoti Balla, në fakt, mund të mos i gjesh me vend pyetjet, por unë nuk e gjej me vend fare këtë deklaratë që bëre dhe kjo është mënyra më e qetë për ta thënë.

E para, në këtë komision, grushtimi dhe lufta kanë ngelur jashtë dore për një arsye të thjeshtë, sepse ky proces është procesi i të gjithë shqiptarëve. Kolegut, nuk bëri asgjë tjetër veçse kërkoi mendimin e ministres mbi një deklaratë të Kryeministrit me etiketime, të cilat jo që nuk i bëjnë nder këtij komisioni, por nuk i bëjnë nder asnjërit prej nesh.

Ky nuk është një proces ku shqiptarët mund të ndahen në shqiptarë dhe serb, duke shpresuar që nuk po kuotoj këtu asnjë vend fqinj dhe as qytetarët e një vendi fqinj. Ky është një proces, në të cilin ne kemi detyrime për të zbatuar dhe për sa kohë kemi detyrime për të zbatuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo.

Kjo ka lidhje sepse ne kemi thirrur ministren këtu për të raportuar mbi detyrimet. Në rast se ky proces has në problematika, në rast se ne kemi probleme me njëri-tjetrin të polarizimit dhe të politikës sonë të brendshme, në rast se ne kemi probleme, sepse nuk ulemi në tavolinë dhe nuk arrijmë dot t'i bëjmë reformat gjithëpërfshirëse, sepse nuk kemi dashur që të jenë gjithëpërfshirëse, nuk mund t'i shtojmë këtu edhe element...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk bëri pyetje për bashkimin me Kosovën.

Zoti Abazi, ju lutem! Zotëria është përgjegjës vetë në përgjigje, mos e kaloni cakun e diskutimeve dhe mos u merrni me çështje kombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, dëgjo! Përgjigjen ta jep ai dhe unë.

Një sekondë, sepse po e drejtoj unë mbledhjen. Mos fusni çështje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edi, të lutem! Unë flas në kapacitetin tim si drejtuese e komisionit dhe po ju sugjeroj: mos përfshini çështje që janë më të nxehta se kapaciteti intelektual i gjithsecilit prej jush në këtë diskutim.

Kam thirrur ministren për të raportuar mbi plotësimin e detyrimeve të Shqipërisë, të munguara apo sipas këndvështrimit të saj dhe të qeverisë, të plotësuara. Këtu fillon dhe këtu duhet të mbarojë ky diskutim. Mos përfshini çështje që kalojnë më shumë se sa kapaciteti juaj! Është e turpshme për shqiptarët të flasim dhe të krijojmë jo hipoteza, por as dyshime, për të dëgjuar një tjetër dhe për më tepër të dalë nga ky komision.

Zoti Paloka, urdhëroni!

Edi Paloka – Edhe një herë zonja Ministre, sepse pyetjet jua bëj juve dhe përgjigjet i dua nga ju, jo nga ky zotëria, për të mos thënë ndonjë gjë tjetër... Ke ngatërruar vendin këtu. Kujton se je piktor! Në rregull, je! Unë nuk jam piktor. Pikturën ta bëjë në një vend tjetër.

Zonja Ministre, pyetja ime ishte kjo, pavarësisht interpretimit që kanë dëshirë t'i japin, dhe çuditërisht nuk e përmenda Kryeministrin në pyetje, dhe kur të zbardhet procesverbali do ta shikoni se nuk e kam përmendur Kryeministrin në pyetjen time, por meqë këta e dinë që këtë qëndrim e ka mbajtur Kryeministri, unë tani do t'ju pyes direkt: Çfarë mendimi keni ju për qëndrimet e Kryeministrit të Shqipërisë të bëra publike dhe të kundërshtuara hapur në Parlamentin Europian dhe nga BE-ja, lidhur me presionet që i bëhen

BE-së, me lloj- lloj deklaratash: “Nëse Europa nuk na pranon, Shqipëria rrezikon të bëhet pre e terrorizmit”.

E dyta, nëse Europa nuk na pranon të bashkohemi në Europë ne do të bashkohemi fizikisht me Kosovën.

Të dyja deklaratatë të bëra publike nga Kryeministri i Shqipërisë, pavarësisht se e ka qejf atë tërheqje se nuk po ia them ndryshe, jemi mësuar që Kryeministri të shikojë bomba dhe të fusë... jo indietron, quhet ndryshe ajo.

Ministre ju pyeta: Çfarë qëndrimi mbani në lidhje me këto pozicione të Kryeministrit? Jeni edhe ju në të njëjtin pozicion apo mendoni ndryshe?

(Diskutime pa mikrofon.)

Klajda Gjosh – Zoti Paloka, unë jua dhashë përgjigjen time. E përmbledh vetëm me një fjalë: qëndrimi i qeverisë shqiptare është Shqipëria në Europë dhe ky është i vetmi proces që po ndërmer vendi. Faleminderit!

Majlinda Bregu – Në qoftë se janë ezauruar të gjitha përgjigjet e pyetjeve, ka pyetje të tjera nga maxhoranca? Jo. Po ju pyes për barazi, për gjithëpërfshirje.

(Diskutime pa mikrofon.)

Gerti Bogdani – Është pikërisht kjo e fundit që thotë zoti Paloka, që fatkeqësisht gjërat që thotë Kryeministri nuk ia merr njeri seriozisht dhe nuk ia marrin më seriozisht as partneret ndërkombëtarë duke thënë një herë, po, të marrim armët kimike, pastaj, jo, të mos i marrim armët kimike. E kundërshtuan me qindra e mijëra qytetarë, që e detyruan Kryeministrin të thoshte jo, por më vjen keq që kolegët deputetë, qoftë edhe në këtë rast ministrja, detyrohen të bëjnë mbrojtje me sofizma jo me keqkuptime si deklaratatë serbo-malazeze apo ku di unë; detyrohen të mbrojnë disa delintatizma dhe gafa të Kryeministrit në politikën e jashtme, që zoti Balla e kishte merak politikën e jashtme.

Megjithatë pyetja është përsëri shumë specifike. Vala e fundit e emigracionit të qytetarëve shqiptarë numërohet në disa mijëra azilkërkues në çdo muaj, duke filluar nga janari, shkurti marsi i këtij viti dhe kam përshtypjen se ka ngritur shqetësim në autoritetet e shteteve të BE-së, mbi të gjitha atë të Gjermanisë, më pas Suedisë etj., me radhë, sepse shifrat janë shumë alarmante krahasuar qoftë edhe me muajt e parë apo vitet e para menjëherë pas liberalizimit të vizave.

Pra është situata e rëndë ekonomike dhe politike që i detyron shqiptarët sot të largohen dhe të emigrojnë. Sa mendoni ju se ndikon në procesin e integritimit europian të

Shqipërisë ose në statusin e vizave të liberalizuara për shqiptarët dhe pa diskutim pastaj në progresraportin e vitit 2014?

Faleminderit!

Klajda Gjoshaj – Të falënderoj për pyetjen, zoti Bogdani!

Situata e krijuar së fundi ka qenë tejet shqetësuese dhe patjetër që e prek procesin e integritit. Unë dëshiroj edhe nga ky komision t'u bëj thirrje të gjithë shqiptarëve që të respektojnë rregullat e Shengenit, të respektojnë rregullat dhe të mos largohen nga vendi për të kërkuar azil në vendet e BE-së, sepse askush nuk do t'ua hapë dyert për të qëndruar në këto vende të zhvilluara të Europës. Në këtë mënyrë dëshiroj t'u them të gjithë atyre se Shqipëria dhe qeveria po ndërmerr reforma të duhura në mënyrë që t'u vijë në ndihmë të gjithë qytetarëve shqiptarë dhe për të zhvilluar ekonominë e vendit, por edhe për të krijuar mundësinë për të gjithë këta qytetarë për të hapur vende të reja pune.

Ky është mesazhi im që kam dhe kjo ishte që mund të thosha për një nga pyetjet më të mira të këtij komisioni, sepse ishte situatë shqetësuese e ditëve të fundit dhe unë do tu lutesha të gjithë qytetarëve shqiptarë, sepse janë ata, në radhë të parë, që e kanë prioritet procesin e integritit dhe shkuarjen e Shqipërisë në Europë, të mos e cenojnë atë, por të respektojnë çdo rregull brenda dhe jashtë vendit. Faleminderit!

Majlinda Bregu – Zonja Ministre, përveç thirrjeve dhe apeleve që janë të domosdoshme, megjithëse me vonese nga qeveria, për shqiptarët, sepse keni reaguuar pasi kishte mbërritur numri vetëm për 3- mujorin e parë të 2015 mbi 6000 vetë, a keni ndonjë plan konkret si të ndalet ky eksod i dhimbshëm?

Klajda Gjoshaj – Patjetër që Ministria e Brendshme është duke punuar për të ndaluar eksodin, por edhe për të kuptuar arsyet e largimeve të qytetarëve shqiptarë drejt vendeve të BE-së.

Janë planet, janë konkrete dhe është punë e përditshme që bën Ministria e Brendshme dhe e gjithë qeveria për të ndalur këtë shifër të të larguarve.

Gerti Bogdani – Më vjen keq që planet e qeverisë shqiptare për të ndaluar eksodin kufizohen vetëm te planet e Ministrisë së Brendshme, çka do të thotë plane të kontrollit të kufirit dhe të kontrollit e të kufizimit të lëvizjes së lirë të qytetarëve shqiptarë, liri që shqiptarët e fituan me shumë mund, qofshin këta të majtë, të djathtë apo të qendrës, apo të anës. Vetëm pas 20 vjetësh tranzicion dëgjojmë që ka reforma të mirëfillta për ndryshimin e rënies ekonomike, për drejtimin që ka marrë ekonomia, për hapjen e vendeve të reja të punës

jo të atyre 138, që përmendën më parë, përmirësimin e kushteve të shqiptarëve në tërësi dhe në mbrojtjen e të drejtave...

Majlinda Bregu – 138 për dy vjet, 300 mijë për katër vjet. Ka kohë.

Gerti Bogdani – Po, kalon. Logjika ekziston, por sidoqoftë, besoj se do të ishte shumë më e rëndësishme të kishte plane konkrete për qytetarët shqiptarë për të mos u larguar. Janë të rëndësishme, por përgjegjësia nuk duhet t'u kërkohej qytetarëve shqiptarë, përgjegjësia në këtë rast është mbi të gjithë, dhe në radhë të parë, e qeverisë më pas e gjithë klasës politike, sepse janë politikat e asaj që detyrojnë qytetarët të largohen. Por sidoqoftë përgjigjja e ministres është më e mirë se përgjigjja e ministrit, që u tall përpara dy javësh që tha se shqiptarët të ikën se jashtë jetohet më mirë. Faleminderit!

Majlinda Bregu – Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje tjetër? Nëse nuk ka pyetje të tjera, zonja Ministre në përmbledhje të këtij informimi tuaj, e para inputin që keni dorëzuar të progres-raportit ta përcillni në komision urgjentisht.

E dyta, të gjitha detyrimet që parashikon ligji për rolin kontrollues të Kuvendit në procesin e integritetit të plotësohen brenda muajit maj. Duhet të ishin plotësuar në fillimviti, e përsëris për faktin që ligji u propozua hyri në fuqi nga fondi i shkurtit. Kanë kaluar edhe 3 muaj të tjerë, prandaj deri në fund të muajit maj raportimet që keni për të bërë në Kuvend në Komisionin e Integritetit për sjelljen e të gjitha akteve dhe projektligjeve, që do të miratohen deri në fund të vitit, duhet t'i përcillni brenda muajit maj.

Besoj që përtej përgjigjeve që ju dhatë, nuk e di sa i kanë marrë përgjigjet kolegët për të gjitha pyetjet, më lejoni t'ju sugjeroj në këtë çështje të ndjeshme për të gjithë shqiptarët dhe nuk besoj se shmangia e diskutimit mbi çështjen e eksodit të shqiptarëve e bënë problemin më të lehtë, do të bënit mirë që të mos ia linit vetëm Saimir Tahirit të kontrollonte pikat e kalimit kufitar, por të paktën të lëviznit, meqë keni edhe fushatën e zgjedhjeve lokale, për të kuptuar dhe për të zhvilluar strategji në terren, për t'i ndihmuar ata njerëz dhe ata qytetarë, sidomos nga zonat, të cilat rezultojnë si më problematike dhe ku ende fatkeqësisht Rilindja për dy vjet nuk ka mbërritur. Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA